



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 28, datë 29.08.2019

Mbi miratimin e Raportit për realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për tremujorin e dytë të mbyllur më 30 Qershor 2019

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, të nenit 53, pika 5, shkronja “ë” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “d”, të nenit 8, pika 2, shkronja “m” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin për realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për tremujorin e dytë të mbyllur më 30 Qershor 2019, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar